



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:183214
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05605854

PPP.nr.3331/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil, me gjyqtarin Shaban Prekalla, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “K.R.M.P” SH.A, adresa rruga “B.C”, në Prishtinë, kundër debitorit A.H.T me adresë rruga “H.Z” nr.1.../A, të cilin e përfaqëson me autorizim avokat Bahtir Troshupa nga Prishtina adresa rruga “Meto Bajraktari”, nr. 14, lidhur me çështjen përmbartimore për borxh, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i debitorit datë 30.11.2020, kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit numër P.nr.1445/20 i datës 13.11.2020, të lejuar nga përmbartuesi Privat Eset Murati në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 23.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET në tërësi i bazuar prapësimi i përfaqësuesit të autorizuar të debitorit A.H.T, avokat Bahtir Troshupa, ashtu që **ANULOHET** Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.1445/20 i datës 13.11.2020, i lejuar nga përmbartuesi Privat Eset Murati në Prishtinë, si dhe refuzohet propozimi për përmbartim i paraqitur me datë 13.11.2020 nga kreditori “K.R.M.P” me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Flamur Bogaj në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdher me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm-kartelës së konsumatorit për periudhën kohore nga viti 01.02.2007 deri në 01.01.2009, në shumë prej 101.65 euro, me të cilin ka kërkuar që debitori të obligohet që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrimit t’i paguaj kreditorit borxhin me kamatë prej 8%, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e përmbartimit.

Kundër urdhrimit për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim në të cilin ka theksuar se e kundërshton propozimin për përmbartim për shkak se kërkesa është parashkruar në tërësi, ka skaduar afati kohor brenda të cilit sipas ligjit mund të kërkohej bërmbartim neni 71 pika 1.4 LPP-së, lidhur me nenin 360 pika 1.1 të LMD-së duke i propozuar gjykatës që të aprovoj prapësimin si të bazuar.

Kreditori nga ana e Përmbartuesit Privat është njoftuar për prapësimin e bërë nga ana e kreditorit dhe i

njëti është informuar për të drejtën e tij për përgjigje në prapësim në afat prej tri (3) ditësh, mirëpo i njëti nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i bazuar, nga këto arsye:

Lidhur me pretendimet e debitorit lidhur me afatet e parashkrimit ka ardhur në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrimin të kërkesës së kreditorit në pajtim me dispozitat e nenit 378 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Gazeta Zyrtare nr.29/78 kohë në të cilën ka qenë në fuqi ky ligj. Sipas këtij neni: *“Parashkruhen për një vit: kërkesa e kompensimit për livrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit dhe shërbimet e spastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi, respektivisht shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*. Kurse neni 361 i LMD-së rregullon se: *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Në këtë drejtim, kreditori ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga momenti arritjes së kërkesës për pagesë, ndërsa periudha e fundit që është kërkuar në bazë të ekstratit është data 01.01.2009, kurse propozimi për përmbarim nga kreditori paraqitet me datë 13.11.2020.

Sipas nenit 43 par. 4 të LPP-së *“Përmbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarueshmërinë rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngreh kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhringa përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim. Andaj, gjykata në rastin konkret vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat.*

Gjykata, analizoi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo te njëjtat nuk kishin rendësi vendimtare në vendosjen sipas prapësimit, ngase kërkesa ishte përfshirë në parashkrim.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, prandaj anuloi urdhrin përmbarimor.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.3331/2020 datë, 23.04.2024

Gjyqtari,
Shaban Prekalla

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.